

RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE REKOMANDIMET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PARMANENTARE 2025 SHOQATA “SEBASTIA”



RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE REKOMANDIMET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PARMANENTARE 2025 QARKU LEZHË

PROJEKTI: “E ARDHMJA JONË, VOTA JONË”

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e projektit “Pjesëmarrja e OSHC-ve në proceset zgjedhore për një demokraci më të fortë dhe përsheptimin e integritetit në BE”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike dhe Instituti për Studime Publike dhe Ligjore.

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve financiar të tij, Bashkimi Evropian, QKBAT dhe IPLS.

PËRMBAJTA

1. HYRJE	5
1.1 Qëllimi i raportit	7
1.2 Zona dhe periudha e monitorimit	8
1.3 Rëndësia e monitorimit zgjedhor	10
1.4 Organizata dhe partnerët	11
2. METODOLOGJIA E MONITORIMIT	12
2.1 Ekipi i monitorimit	12
2.2 Zona dhe qendrat e mbuluara	13
2.3 Instrumentet dhe mjetet e monitorimit	14
2.4 Periudha dhe oraret e vëzhgimit	15
2.5 Limitimet e monitorimit	16
3. KONTEKSTI POLITIK DHE LIGJOR.....	17
3.1 Situata politike para zgjedhjeve	17
3.2 Kuadri ligjor dhe institucionet zgjedhore	18
3.3 Roli i partive politike dhe aktorëve lokalë	19
4. PERIUDHA PARA ZGJEDHJEVE DHE FUSHATA ELEKTORALE.....	21
4.1 Aktivitetet e fushatës	21
4.2 Përdorimi i burimeve publike.....	22
4.3 Presione dhe intimidime.....	23
4.4 Shkeljet dhe parregullsitë e evidentuara.....	23
5. DITA E VOTIMIT – 11 MAJ 2025.....	25
5.1 Hapja e qendrave të votimit.....	25
5.2 Procesi i identifikimit dhe regjistrimit të votuesve	25
5.3 Votimi dhe respektimi i fshehtësisë	26
5.4 Mbyllja e qendrave të votimit	26
5.5 Shkeljet dhe parregullsitë gjatë ditës së votimit.....	26

6. PROCESI I NUMËRIMIT.....	28
6.1 Organizimi dhe mbarëvajtja e numërimit.....	28
6.2 Dokumentimi dhe transparenca.....	28
6.3 Problematikat dhe shkeljet e evidentuara.....	29
6.4 Raportimi dhe shpallja e rezultateve	30
7. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME	32
7.1 Përfundime të përgjithshme.....	32
7.2 Rekomandime strategjike për proceset e ardhshme	33

LISTA E SHKURTIMEVE

QKBTAT – Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike

IPLS – Institute for Political and Legal Studies

BE – Bashkimi Evropian

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KAS – Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve

KZAZ – Komisioni Zonale i Administrimit të Zgjedhjeve

KQV – Komisioni i Qendrës së Votimit

QV – Qendër Votimi

PEI – Pajisja Elektronike e Identifikimit

LTO – Vëzhgues Afatgjatë

(Long Term Observer)

STO – Vëzhgues Afatshkurtër

(Short Term Observer)

PS – Partia Socialiste

PD-ASHM – Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore

PSD – Partia Socialdemokrate

NGO / OJF – Organizatë Joqeveritare

1. HYRJE

Zgjedhjet përfaqësojnë një nga shtyllat më të rëndësishme të funksionimit të një sistemi demokratik dhe janë mekanizmi përmes të cilit qytetarët ushtrojnë të drejtën e tyre për të zgjedhur përfaqësuesit dhe për të ndikuar në drejtimin politik të vendit. Në këtë kontekst, monitorimi i zgjedhjeve luan një rol themelor në garantimin e integritetit të procesit zgjedhor, transparencës së tij dhe përforcimit të besimit të publikut në institucionet demokratike. Në Shqipëri, zhvillimi i demokracisë dhe zgjedhjeve të lira dhe të ndershme ka qenë një proces sfidues, shpesh i shoqëruar me tensione politike, polarizim dhe kritika mbi administrimin e zgjedhjeve. Për këtë arsye, angazhimi i shoqërisë civile në vëzhgimin zgjedhor është bërë një domosdoshmëri për të kontribuar në rritjen e llogaridhënies dhe përmirësimin e praktikave demokratike.

Ky raport përfaqëson një përpjekje të rëndësishme të organizatës "Sebastia" për të ofruar një pasqyrë të plotë, të paanshme dhe të mirëargumentuar të procesit të Zgjedhjeve të Përgjithshme Parlamentare të mbajtura më 11 maj 2025 në Qarkun Lezhë. Ky angazhim është realizuar në kuadër të projektit "E ardhmja jonë, vota jonë", me mbështetjen e organizatës ANTTARC dhe Institutit për Politika dhe Liderhip Social (IPLS), dhe me financim të Bashkimit Evropian. Kjo nismë është ndërtuar mbi një filozofi pjesëmarrëse që synon jo vetëm të evidentojë problematikat në menaxhimin e zgjedhjeve, por edhe të promovojë praktika të mira dhe të kontribuojë në edukimin demokratik të komunitetit lokal.

Raporti nuk synon vetëm të informojë mbi qëllimin dhe metodologjinë e monitorimit, por edhe të krijojë një kornizë më të gjerë analitike për të kuptuar pse një proces zgjedhor është më shumë se një ditë votimi. Është një reflektim i shoqërisë në tërësi, i mënyrës se si funksionojnë institucionet, i mënyrës se si qytetarët e perceptojnë dhe e ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrje. Në këtë kuptim, raporti shërben si një pasqyrë jo vetëm e realitetit politik të Qarkut Lezhë, por edhe e zhvillimit të kulturës demokratike në vend.

Qarku i Lezhës, që përfshin bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë, përbën një realitet të larmishëm social dhe politik, ku ndërthuren dinamika urbane dhe rurale, sfida ekonomike dhe sociale, si dhe interesa të ndryshme politike. Ky kontekst e bën edhe më të rëndësishëm vëzhgimin e zgjedhjeve, pasi ofron mundësi për të kuptuar më mirë se si faktorët lokalë ndikojnë në cilësinë e procesit zgjedhor. Organizata "Sebastia" ka ndërtuar këtë raport bazuar në një monitorim gjithëpërfshirës,

të zhvilluar me standarde të larta profesionale, përmes angazhimit të një ekipi prej 7 vëzhguesish afatgjatë (LTO) dhe 20 vëzhguesish afatshkurtër (STO), të trajnuar dhe të pajisur me instrumente të posaçme për vëzhgimin e procesit zgjedhor.

Procesi i monitorimit është përqendruar në të tri fazat kryesore të zgjedhjeve: periudha parazgjedhore dhe fushata elektorale; dita e votimit dhe procedurat përkatëse të hapjes, votimit dhe mbylljes së qendrave të votimit; si dhe procesi i numërimit të votave. Çdo fazë është vëzhguar në mënyrë të strukturuar, përmes formularëve të standardizuar, ditarëve të detajuar dhe dokumentimit vizual, si dhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta me aktorët lokalëpërfshirë përfaqësues të administratës zgjedhore, kandidatë, qytetarë dhe media.

Në këtë raport, organizata "Sebastia" synon të shkojë përtej raportimit teknik të të dhënave. Qëllimi është të ofrojë një narrativë që përfshin përjetimet e komunitetit, kontekstin social dhe politik, sfidat me të cilat përballen qytetarët në ushtrimin e të drejtës së votës, si dhe ndikimin që praktikatat zgjedhore kanë në përforcimin ose dobësimin e demokracisë lokale. Raporti paraqet jo vetëm fakte, por edhe analiza, rekomandime dhe reflektime që synojnë të jenë një kontribut i vlefshëm për të gjitha palët e interesuara: institucionet zgjedhore, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët.

Një aspekt thelbësor i këtij raporti është fokusi në përfshirjen e grupeve të marginalizuara, veçanërisht të rinjtë dhe gratë, të cilët shpesh përballen me barriera strukturore dhe sociale në pjesëmarrjen politike. Përmes këtij projekti, "Sebastia" ka synuar të fuqizojë rolin e këtyre grupeve si pjesëmarrës aktivë në procesin zgjedhor, jo vetëm si votues, por edhe si vëzhgues, monitorues dhe kontribuues në diskutimin publik. Kjo qasje përputhet me standardet ndërkombëtare për zgjedhje gjithëpërfshirëse dhe të barabarta, dhe reflekton angazhimin e organizatës për një demokraci që i jep zë të gjithëve.

Theksohet gjithashtu rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe roli i mbështetjes ndërkombëtare në ndërtimin e kapaciteteve lokale për monitorim dhe advokim. Projekti "E ardhmja jonë, vota jonë" është një shembull i qartë i mënyrës se si mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë mund të fuqizojë aktorët lokalë për të rritur ndikimin e tyre në proceset demokratike. Bashkëpunimi me ANTTARC dhe IPLS ka ofruar një strukturë të fortë për trajnim, koordinim dhe analizë, ndërsa mbështetja e Bashkimit Evropian ka mundësuar zbatimin e këtij projekti në një shkallë më të gjerë dhe me ndikim të qëndrueshëm.

Raporti i organizatës "Sebastia" përfaqëson një përpjekje serioze dhe të përkushtuar për të ndihmuar në rritjen e cilësisë së zgjedhjeve në Shqipëri, përmes monitorimit të pavarur, analizës së paanshme dhe promovimit të pjesëmarrjes qytetare. Ky raport është një kontribut i vlefshëm në literaturën e monitorimit zgjedhor dhe një mjet për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe demokracinë në nivel lokal dhe kombëtar.

1.1 Qëllimi i raportit

Qëllimi i raportit të monitorimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme Parlamentare të mbajtura më 11 maj 2025 në Qarkun Lezhë është të ofrojë një analizë të gjithanshme, objektive dhe të paanshme të të gjitha fazave të procesit zgjedhor, nga periudha parazgjedhore, dita e votimit, deri te numërimi i votave dhe shpallja e rezultateve. Ky raport ka për qëllim të pasqyrojë realitetin e administrimit të zgjedhjeve në një territor të gjerë dhe socialisht të ndryshëm siç është Qarku i Lezhës, duke reflektuar mbi përputhshmërinë e procesit me ligjin, standardet kombëtare dhe praktikatat më të mira në nivel ndërkombëtar.

Monitorimi i zgjedhjeve nga organizata “Sebastia” është kryer në kuadër të projektit “E ardhmja jonë, vota jonë”, i mbështetur nga ANTTARC dhe IPLS dhe i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky angazhim ka synuar jo vetëm vëzhgimin e drejtpërdrejtë të zhvillimeve zgjedhore, por edhe ndërtimin e një kulture të re të pjesëmarrjes qytetare, ku procesi zgjedhor konsiderohet si një mjet themelor për fuqizimin e demokracisë dhe jo thjesht si një mekanizëm formal i rotacionit politik.

Qëllimi i raportit është të identifikojë jo vetëm problematikat dhe sfidat që karakterizuan zgjedhjet, por edhe praktikatat pozitive, shembujt e administrimit të suksesshëm dhe mekanizmat institucionalë që kontribuan në ruajtjen e integritetit të votës. Raporti i kushton vëmendje të veçantë elementëve si funksionimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit, roli i Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, prezenca e forcave politike, informimi i qytetarëve, transparenca, aksesueshmërinë e votimit për persona me aftësi të kufizuara dhe atmosferën e fushatës elektorale.

Raporti synon gjithashtu të kontribuojë në procesin e reflektimit institucional, duke ofruar rekomandime të qarta dhe të arsyetuara për institucionet përgjegjëse si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, subjektet politike, administrata vendore dhe organizatat e shoqërisë civile. Duke analizuar zhvillimet e vërejtura në terren, raporti paraqet një tablo të qartë mbi qasjen institucionale ndaj zgjedhjeve dhe shkallën e profesionalizmit me të cilën ato janë administruar.

Pjesë e qenësishme e qëllimit të raportit është edhe mbrojtja dhe promovimi i të drejtave qytetare. Raporti synon të evidentojë nëse procesi ka garantuar barazi në pjesëmarrje, qasje të barabartë në informacion dhe trajtim korrekt për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie, moshe, statusi social apo aftësish. Ai trajton gjithashtu angazhimin e grupeve vulnerabël, duke analizuar nëse fushata elektorale dhe struktura organizative zgjedhore kanë reflektuar ndjeshmëri ndaj këtyre grupeve. Një element shtesë i raportit është roli i edukimit qytetar në cilësinë e zgjedhjeve. Gjatë procesit të monitorimit, organizata “Sebastia” ka vërejtur se në shumë zona ka munguar informimi i duhur mbi procedurat zgjedhore, veçanërisht te votuesit e rinj. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për të marrë vendime të informuara dhe ka rritur rrezikun për ndikime të padrejta. Për rrjedhojë, raporti e sheh si qëllim të tij promovimin e programeve të edukimit qytetar, si pjesë thelbësore e zhvillimit të demokracisë.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, ky raport ka si qëllim kryesor të ofrojë një tablo të saktë dhe të thelluar të zhvillimit të zgjedhjeve parlamentare në Qarkun Lezhë, në mënyrë që të ndihmojë institucionet dhe shoqërinë civile të reflektojë, të nxjerrë mësim dhe të hartojë politika që garantojnë procese gjithnjë e më cilësore, të ndershme dhe të besueshme në të ardhmen.

1.2 Zona dhe periudha e monitorimit

Monitorimi zgjedhor në kuadër të projektit “E ardhmja jonë, vota jonë” është shtrirë në të tri bashkitë që përbëjnë Qarkun Lezhë: Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Përzgjedhja e këtyre zonave u bë me qëllim për të siguruar një përfaqësim sa më të gjerë të realitetit lokal dhe për të reflektuar diversitetin administrativ, demografik dhe politik që karakterizon këtë qark. Kjo shtrirje gjeografike ka mundësuar identifikimin dhe analizimin e sfidave dhe praktikave të ndryshme që lidhen me organizimin e zgjedhjeve në zona me karakteristika të ndryshme socio-ekonomike, përfshirë zonat urbane me dendësi të lartë popullsie dhe zonat rurale me akses të kufizuar në shërbime publike.

Në mënyrë që të arrihej një pasqyrë sa më përfaqësuese e të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor, monitorimi është zhvilluar përgjatë një periudhe të zgjeruar kohore, duke përfshirë katër faza kryesore: periudhën parazgjedhore, fushatën elektorale, ditën e votimit dhe procesin e numërimit të votave. Kjo qasje ka lejuar që të dokumentohen zhvillimet dhe ndërveprimet institucionale dhe politike në një mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme.

Periudha e monitorimit ka nisur zyrtarisht në muajin mars 2025, me vendosjen në terren të vëzhguesve afatgjatë (LTO), të cilët kanë ndjekur nga afër përgatitjet e administratës zgjedhore në nivel vendor, listat e zgjedhësve, trajnimin e komisionerëve dhe informimin publik mbi procesin zgjedhor. Kjo fazë fillestare ka qenë e rëndësishme për të kuptuar nivelin e organizimit dhe gatishmërisë së institucioneve për zhvillimin e zgjedhjeve.

Në vijim, gjatë muajit prill dhe fillim maj 2025, fokusi i monitorimit është përqendruar në aktivitetet e fushatës elektorale të partive politike dhe kandidatëve të pavarur. Vëzhguesit kanë ndjekur aktivitetet publike, mënyrën e përdorimit të hapësirave publike dhe mediatike, si dhe respektimin e etikës politike dhe të barazisë në garë. Kjo fazë është shoqëruar me raportime të rregullta dhe dokumentim të rasteve të shkeljeve të mundshme ose praktikave pozitive.

Më 11 maj 2025, gjatë ditës së votimit, u angazhua një numër më i madh vëzhguesish afatshkurtër (STO), të cilët bashkë me LTO-të mbuluan një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit në të tri bashkitë. Monitorimi i ditës së votimit është përqendruar në vëzhgimin e hapjes së qendrave, zbatimin e procedurave të votimit, mbylljen dhe transportin e materialeve zgjedhore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit për persona me aftësi të kufizuara, pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve, si dhe incidenteve të mundshme që kanë ndikuar mbi rregullsinë e procesit.

Pas përfundimit të votimit, monitorimi ka vijuar me vëzhgimin e procesit të numërimit të votave, i cili është realizuar në ambientet e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ). Kjo fazë ka përfshirë vëzhgimin e transparencës, aksesit të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të pavarur, si dhe respektimin e procedurave për përlllogaritjen dhe shpalljen e rezultateve paraprake.

Monitorimi është realizuar nga një ekip i trajnuar prej 27 vëzhguesish, përfshirë 7 afatgjatë dhe 20 afatshkurtër, të cilët janë shpërndarë në mënyrë strategjike për të mbuluar zona me prioritet të lartë, përfaqësim të barabartë gjeografik dhe për të identifikuar praktikrat specifike në kontekste të ndryshme. Kjo strukturë ka garantuar një mbulim të ekuilibruar dhe të besueshëm të zonës së monitorimit, duke prodhuar të dhëna të vlefshme për analizë.

Kjo përjasje në hartimin e zonës dhe periudhës së monitorimit ka shërbyer si themel për ndërtimin e një raporti që i përgjigjet realiteteve në terren dhe që kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e administrimit të zgjedhjeve dhe të pjesëmarrjes qytetare në proceset demokratike.

1.3 Rëndësia e monitorimit zgjedhor

Monitorimi zgjedhor është një instrument thelbësor për forcimin e integritetit të proceseve demokratike dhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve. Në mënyrë të strukturuar dhe të pavarur, monitorimi shërben për të vlerësuar përputhshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve me standardet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, për të identifikuar praktikat pozitive, si dhe për të evidentuar problematika apo devijime që cenojnë të drejtën e qytetarëve për të votuar lirshëm dhe të informuar.

Rëndësia e tij qëndron në funksionin mbikëqyrës dhe parandalues që ushtron ndaj çdo faze të procesit zgjedhor, duke ndihmuar në sigurimin e një gare të ndershme dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit politikë. Përmes vëzhgimit sistematik dhe raportimit të fakteve, monitorimi kontribuon në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe proceseve demokratike, si dhe nxit përmirësime konkrete në legjislacionin dhe administrimin zgjedhor.

Monitorimi gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në dokumentimin dhe analizimin e qasjes së grupeve të ndryshme të shoqërisë në procesin zgjedhor, përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet e marginalizuara. Në këtë mënyrë, ai ndihmon në vlerësimin e nivelit të gjithëpërfshirjes dhe aksesueshmërisë së zgjedhjeve dhe në formulimin e politikave që sigurojnë pjesëmarrje sa më të gjerë e të barabartë.

Në rastin konkret të Qarkut Lezhë, rëndësia e monitorimit ka qenë e shumëfishtë për shkak të diversitetit të madh social dhe gjeografik të zonës, si dhe sfidave të konstatuara në ciklet e mëparshme zgjedhore. Përmes një monitorimi të detajuar në tri bashkitë e qarkut, janë siguruar të dhëna objektive mbi organizimin dhe zbatimin e procesit zgjedhor, si dhe janë identifikuar faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe besueshmërinë e tij.

Monitorimi gjithashtu përbën një mekanizëm të rëndësishëm advokimi për organizatat e shoqërisë civile, duke u ofruar atyre informacion të verifikuar dhe të detajuar për të mbështetur ndërhyrje të orientuara drejt përmirësimit të demokracisë funksionale në nivel lokal dhe kombëtar. Të dhënat dhe gjetjet e monitorimit mund të përdoren nga institucionet publike për të reflektuar mbi performancën e tyre dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese në kohë.

Në përmblendje, rëndësia e monitorimit zgjedhor qëndron në kontributin që ai jep për:

- ♦ rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor;
- ♦ sigurimin e një gare të barabartë dhe gjithëpërfshirëse;

- ◆ forcimin e mekanizmave të llogaridhënies institucionale;
- ◆ dokumentimin dhe analizën objektive të zhvillimeve zgjedhore;
- ◆ nxitjen e përmirësimeve ligjore dhe procedurale;
- ◆ fuqizimin e shoqërisë civile dhe qytetarëve në mbrojtjen e të drejtave demokratike.

Monitorimi nuk është vetëm një ushtrim teknik, por një proces që ndihmon në ndërtimin e një kulture demokratike, ku çdo qytetar ndjehet pjesë e vendimmarrjes dhe çdo votë trajtohet me dinjitet dhe korrektësi.

1.4 Organizata dhe partnerët

Gjatë periudhës së monitorimit, organizata Sebastia zhvilloi një bashkëpunim të frytshëm me organizata jo-qeveritare lokale që veprojnë në bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë, përfshirë Organizatën “Opportunity Balance and Overcoming”, Qendrën “Shën Jozefi”, Qendrën “Rozalba”, Qendra Rinore “Venrini”, portalin mediatik lokal “PIKTV” dhe Organizatën “Power of Education”. Ky bashkëpunim rezultoi në përforcimin e kapaciteteve të monitorimit dhe mbulimin gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor në nivel lokal. Një pjesë e vëzhguesve afatshkurtër u rekrutuan dhe u trajnuan në bashkëpunim me këto organizata, duke rritur kështu kapacitetin operativ dhe efikasitetin e mbikëqyrjes në terren. Ky koordinim u shfrytëzua për shkëmbimin e informacionit në kohë reale dhe për sigurimin e mbështetjes teknike gjatë gjithë fazave të procesit zgjedhor. Përmes këtij partneriteti, u përmirësua cilësia dhe besueshmëria e të dhënave të mbledhura dhe u rrit transparenca e procesit të monitorimit.

2. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

2.1 Ekipi i monitorimit

Ekipi i monitorimit përbëhej nga një strukturë e organizuar në mënyrë profesionale, me një ndarje të qartë të përgjegjësi dhe një përfaqësim të balancuar gjeografik të tri bashkive të Qarkut Lezhë: Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Ky ekip ishte i përbërë nga 7 vëzhgues afatgjatë (LTO) dhe 20 vëzhgues afatshkurtër (STO), të përzgjedhur mbi bazën e përvojës së mëparshme, kompetencës dhe angazhimit qytetar.

Vëzhguesit afatgjatë ishin të shpërndarë në mënyrë të drejtë, për të mbuluar me vëmendje të gjitha zonat me interes zgjedhor. Në Bashkinë Lezhë u angazhuan 3 vëzhgues afatgjatë, në Kurbin 2 dhe në Mirditë 2, duke krijuar një prani të vazhdueshme në secilën zonë. Ata ishin përgjegjës për mbledhjen e informacionit mbi periudhën parazgjedhore, përfshirë përgatitjet institucionale, edukimin zgjedhor të publikut, afishimin e listave të votuesve, trajnimin e administratës zgjedhore dhe zhvillimet politike në nivel lokal.

Në ditën e zgjedhjeve, angazhimi u zgjerua me 20 vëzhgues afatshkurtër, të cilët u shpërndanë në mënyrë proporcionale: 8 në Bashkinë Lezhë, 6 në Bashkinë Kurbin dhe 6 në Bashkinë Mirditë. Vëzhguesit afatshkurtër patën si detyrë të vëzhgonin qendrat e votimit, të monitoronin hapjen, votimin dhe mbylljen e qendrave, si dhe të dokumentonin çdo parregullsi në kohë reale, përmes instrumenteve të standardizuara të raportimit.

Trajnimi i vëzhguesve ishte një komponent thelbësor i metodologjisë. Ai u fokusua në aspektet ligjore dhe praktike të monitorimit, përfshirë Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme, etikën e monitorimit dhe përdorimin e formularëve të strukturës raportuese. Trajnimi u zhvillua në formën e moduleve praktike, ku u simulua skenari i ditës së votimit dhe u ndërtuan raste hipotetike për t'u diskutuar në grup.

Një veçanti e këtij projekti ishte përfshirja e përfaqësuesve nga organizatat lokale të shoqërisë civile në procesin e rekrutimit të vëzhguesve. Kjo rriti ndjeshëm legjitimitetin dhe kapilaritetin e rrjetit të monitorimit, pasi përfshi u qytetarë të angazhuar në komunitet, të cilët kishin njohje të mirë të realiteteve lokale. Përfshirja e tyre ndihmoi gjithashtu në krijimin e një atmosfere

bashkëpunuese ndërmjet vëzhguesve dhe aktorëve lokalë, si administrata zgjedhore, grupet rinore, mediat vendore dhe përfaqësuesit politikë.

Struktura organizative e ekipit parashikonte gjithashtu rolin e një koordinatori rajonal, i cili mbikëqyri punën e të gjithë vëzhguesve, verifikoi saktësinë e të dhënave të raportuara dhe siguroi raportimin në kohë të çdo situatë që kërkonte ndërhyrje ose komunikim të menjëhershëm me institucionet.

Ekipi i monitorimit, në tërësinë e tij, ka funksionuar si një mekanizëm i integruar, ku bashkëpunimi, profesionalizmi dhe angazhimi qytetar janë kombinuar për të garantuar një proces monitorimi të besueshëm dhe të dokumentuar në mënyrë të plotë. Ky model organizimi përbën një praktikë të mirë që mund të replikohet edhe në zgjedhje të ardhshme në nivel lokal apo kombëtar.

2.2 Zona dhe qendrat e mbuluara

Procesi i monitorimit në Qarkun Lezhë është shtrirë në mënyrë strategjike në të tri bashkitë e këtij qarku: Lezhë, Kurbin dhe Mirditë, përmes katër Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ): KZAZ 12 dhe 13 në Lezhë, KZAZ 14 në Mirditë dhe KZAZ 15 në Kurbin. Kjo strukturë administrative përfshinte një total prej 245 qendrash votimi, nga të cilat u monitoruan 120 qendra, që përbëjnë rreth 49% të totalit.

Zgjedhja e qendrave të votimit për monitorim është bërë në mënyrë të balancuar, për të përfaqësuar zona me profile të ndryshme urbane dhe rurale, si dhe për të përfshirë zona që në të kaluarën kanë pasur sfida të evidentuara me administrimin zgjedhor. Për shembull, janë përfshirë si qendra në qytetet kryesore, ashtu edhe në fshatra të thellë me akses të kufizuar, në mënyrë që të ofrohet një pasqyrë sa më e plotë e realitetit zgjedhor në qark.

Në Bashkinë Lezhë u monitoruan një numër i lartë qendrash për shkak të popullsisë më të madhe dhe numrit më të lartë të votuesve të regjistruar. Ndërkohë, në Kurbin dhe Mirditë, vëmendja u përqendrua në zona me potencial për problematika, si në aspektin e logistikës, përfaqësimit politik apo të aksesit të grupeve të marginalizuara.

Mbulimi i 120 qendrave ka mundur dokumentimin dhe analizën e situatave të ndryshme të administrimit zgjedhor, duke ndihmuar në identifikimin e praktikave të mira dhe sfidave të përsëritura. Kjo ka përfshirë vlerësimin e cilësisë së trajnimit të komisionerëve, saktësinë e listave të votuesve, mënyrën e komunikimit me qytetarët dhe funksionimin e pajisjeve të identifikimit elektronik të votuesve (PEI).

Përmes një sistemi të organizuar të shpërndarjes së vëzhguesve, është siguruar një mbulim i drejtë dhe i balancuar gjeografik. Çdo vëzhgues ka ndjekur 2 deri në 4 qendra votimi në ditën e zgjedhjeve, duke e bërë të mundur një vëzhgim gjithëpërfshirës dhe në kohë reale. Zgjedhja e qendrave është bërë edhe në bashkëpunim me aktorë lokalë dhe në bazë të analizës së zgjedhjeve të mëparshme.

Rezultatet e mbledhura nga këto qendra ofrojnë një pasqyrë të qëndrueshme dhe të besueshme mbi performancën e administratës zgjedhore, sjelljen e aktorëve politikë dhe përfshirjen e qytetarëve. Ky mbulim përfaqësues kontribuon në formulimin e rekomandimeve të bazuara në të dhëna konkrete dhe të verifikuara në terren.

2.3 Instrumentet dhe mjetet e monitorimit

Procesi i monitorimit është mbështetur mbi përdorimin e instrumenteve të standardizuara për mbledhjen e të dhënave, të hartuara në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe standardet e vendosura nga organizatat ndërkombëtare të vëzhgimit zgjedhor. Çdo vëzhgues është pajisur me formularë të veçantë për secilën fazë të zgjedhjeve: parazgjedhore, ditën e votimit dhe numërimin e votave.

Formularët përmbanin pyetje të strukturuar dhe hapësira për komente të lira, të cilat mundësonin jo vetëm vlerësimin e procedurave standarde, por edhe kapjen e situatave të veçanta apo joformale. Për shembull, gjatë ditës së votimit janë regjistruar vëzhgime mbi kohën e hapjes së qendrave, sjelljen e komisionerëve, qasjen e personave me aftësi të kufizuara, përdorimin e pajisjes PEI dhe incidentet e mundshme gjatë ditës.

Të dhënat janë përpunuar në mënyrë qendrore përmes një sistemi digjital të raportimit, i cili ka mundësuar analizë të shpejtë dhe të besueshme të informacionit. Kjo ka ndihmuar në përgatitjen e raporteve paraprake në kohë reale, si dhe në përgatitjen e raportit përfundimtar me gjetje të mirëargumentuara.

Përveç formularëve, vëzhguesit kanë përdorur mjete për dokumentim vizual (fotografi, video), ditarë të përditshëm dhe skedarë të komunikimit të brendshëm për të evidentuar rastet më domethënëse. Kjo ka shtuar nivelin e verifikimit dhe ka bërë që raportimi të jetë më i detajuar dhe më i qëndrueshëm.

Instrumentet e përdorura janë testuar paraprakisht gjatë trajnimeve, për të garantuar kuptueshmërinë dhe efektshmërinë e tyre në kushte reale pune. Ato janë përshtatur gjithashtu në

mënyrë që të jenë të përdorshme nga vëzhguesit me përvojë të ndryshme profesionale dhe arsimore, duke siguruar kështu barazi në angazhim dhe besueshmëri në të dhëna.

Kjo metodologji e mbledhjes së të dhënave ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e raportimit, duke e bërë të mundur që konkluzionet e raportit të jenë të mbështetura mbi evidenca të qëndrueshme, të krahasueshme dhe të dokumentuara sipas standardeve.

2.4 Periudha dhe oraret e vëzhgimit

Monitorimi është organizuar në mënyrë që të mbulojë të gjitha etapat kyçe të procesit zgjedhor. Vëzhgimi ka filluar me fazën parazgjedhore, rreth dy muaj përpara ditës së zgjedhjeve, duke vijuar me fushatën zgjedhore, ditën e votimit dhe procesin e numërimit.

Vëzhguesit afatgjatë kanë qenë aktivë që nga marsi 2025, duke ndjekur nga afër aktivitetet përgatitore, trajnimin e administratës, përgatitjen e listave të votuesve, shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe zhvillimet institucionale dhe politike në secilën bashki. Ata kanë marrë pjesë në takime publike, në aktivitete të fushatës, kanë komunikuar me aktorë lokalë dhe kanë dokumentuar çdo element që ka ndikim në cilësinë e procesit.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, monitorimi është zhvilluar në orare të plota, nga hapja e qendrave (ora 06:30) deri në mbylljen e tyre dhe përfundimin e numërimit të votave.

Vëzhguesit kanë ndjekur të gjitha fazat e ditës, duke përfshirë:

- ◆ Hapjen dhe përgatitjen e qendrës;
- ◆ Procesin e identifikimit me pajisjen PEI;
- ◆ Votimin dhe menaxhimin e fluksit të votuesve;
- ◆ Mbylljen e qendrës dhe paketimin e materialeve;
- ◆ Transportin dhe dorëzimin në KZAZ;

Numërimin e votave dhe shpalljen paraprake të rezultateve.

Përmes kësaj metodologjie janë mbledhur të dhëna të vazhdueshme, që reflektojnë situatën reale në çdo moment të ditës. Raportimi në kohë reale ka ndihmuar në identifikimin e shpejtë të parregullsive dhe në ngritjen e alarmeve për incidentet që kërkonin ndërhyrje të menjëhershme nga institucionet.

2.5 Limitimet e monitorimit

Megjithë angazhimin maksimal të burimeve njerëzore dhe logjistike, procesi i monitorimit është përballur me disa kufizime të natyrshme. Së pari, për shkak të numrit të kufizuar të vëzhguesve, nuk ishte e mundur të mbulohej çdo qendër votimi në të gjithë territorin e Qarkut Lezhë. Përafërsisht 49% e qendrave u përfshinë në monitorim, çka e bën analizën të fortë përfaqësuese, por jo të plotë në aspektin statistikor.

Së dyti, vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve u kufizua nga fakti se çdo vëzhgues mund të mbulonte vetëm një numër të caktuar qendrash në një periudhë të kufizuar kohore. Në disa raste, ndërrimet e komisionerëve, vonesat në hapje, apo ndryshimet në planin logjistik kanë ndikuar në vijimësinë e vëzhgimit.

Së treti, në disa zona të thella rurale, vështirësitë infrastrukturore kanë ndikuar në aksesin e vëzhguesve, duke kufizuar praninë e tyre në qendra të largëta. Kjo mund të ketë bërë që disa problematika të mbeten të paidentifikuara.

Së fundi, raportimi bazohet në të dhëna të mbledhura drejtpërdrejt nga vëzhguesit, në intervale të caktuara kohore. Kjo do të thotë që parregullsitë që kanë ndodhur jashtë orarit të vëzhgimit mund të mos jenë dokumentuar.

Megjithatë, pavarësisht këtyre kufizimeve, të dhënat e mbledhura paraqesin një pasqyrë të besueshme dhe të mirëargumentuar të realitetit zgjedhor në Qarkun Lezhë dhe përbëjnë një bazë të vlefshme për analizë dhe rekomandime për përmirësime të mëtejshme në proceset zgjedhore.

3. KONTEKSTI POLITIK DHE LIGJOR

3.1 Situata politike para zgjedhjeve

Në prag të Zgjedhjeve Parlamentare të 2025, klima politike në Qarkun Lezhë ishte e karakterizuar nga polarizim i theksuar, fragmentim i skenës politike dhe një rritje e dukshme e mobilizimit elektoral. Fushata zgjedhore u zhvillua në një ambient të mbushur me tension retorik dhe përplasje ideologjike mes subjekteve tradicionale dhe forcave të reja politike, ku për herë të parë në këtë qark garuan 11 subjekte zgjedhore, duke përfshirë parti politike, koalicione dhe lëvizje qytetare.

Në aspektin e përmbajtjes së fushatës, Partia Socialiste (PS), në cilësinë e forcës qeverisëse, pati një prani intensive në territor përmes strukturave të saj të konsoliduara dhe përdorimit të kapaciteteve logjistike në nivel vendor. Megjithatë, fushata e PS-së u kritikua për mungesën e një platforme të detajuar për zhvillimin rajonal të Lezhës. Komunikimi me qytetarët u fokusua më tepër te mesazhet politike të nivelit qendror, si “Pasaporta Europiane”, sesa në adresimin e sfidave konkrete që përballen qytetarët e Lezhës, si papunësia, migracioni, përkeqësimi i shërbimeve publike dhe menaxhimi i burimeve natyrore.

Nga ana tjetër, Koalicioni PD–Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD–ASHM) u përpoq të aktivizonte bazën e tij tradicionale përmes takimeve publike dhe prezantimit të figurave me profil kombëtar. Fushata kishte natyrë më shumë denoncuese dhe opozitare, pa një ofertë të qartë zhvillimore për rajonin. Përqendrimi te kritikën ndaj qeverisë qendrore e la në hije adresimin e nevojave të komunitetit lokal.

Ndërkohë, subjekte si “Nisma Shqipëria Bëhet” dhe “Lëvizja Bashkë” ofruan alternativa më të artikuluar për pjesëmarrjen qytetare dhe reformën institucionale. “Nisma Shqipëria Bëhet” theksoi shtetin e së drejtës, luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e integritetit të institucioneve, ndërsa “Lëvizja Bashkë” u fokusua në drejtësinë sociale, barazinë gjinore dhe përfshirjen e të rinjve në politikë. Të dyja organizuan takime në komunitet, dëgjesa publike dhe aktivitete me karakter përfshirës, sidomos në zonat urbane dhe rrethina.

Subjektet e tjera si Partia Mundësia dhe Partia Socialdemokrate zhvilluan fushata më të kufizuara, të fokusuara kryesisht në bazën tradicionale elektorale dhe në përfaqësues lokalë. Koalicione dhe lëvizje më të vogla si KEA, LA, AKSH, ADR dhe DZH u karakterizuan nga mungesa e vizibilitetit

dhe përfshirje e ulët në diskursin publik. Aktivitetet e tyre elektorale ishin të kufizuara dhe shpesh pa përmbajtje programore konkrete.

Gjatë monitorimit u vu re një mungesë e theksuar e debateve tematike mbi çështje me interes lokal. Shumica e partive tradicionale nuk ofruan plane të qarta për sektorë kyç si arsimi, shëndetësia, zhvillimi rural dhe përmirësimi i infrastrukturës. Në vend të tyre, fushata u dominua nga slogane të përgjithshme dhe polemika politike. Gjithashtu, u dokumentuan raste të përdorimit të gjuhës diskriminuese nga përfaqësues të Partisë Socialiste në disa takime publike, duke cenuar standardin etik të komunikimit elektoral.

Në tërësi, fushata zgjedhore në Qarkun Lezhë reflektoi një nivel të ulët të orientimit programor dhe një dominim të komunikimit vertikal nga partitë politike. Kjo përbën një sfidë për fuqizimin e demokracisë lokale dhe për angazhimin më të thellë të qytetarëve në procesin zgjedhor si zgjedhës të ndërgjegjshëm dhe aktivë.

3.2 Kuadri ligjor dhe institucionet zgjedhore

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Qarkun Lezhë u zhvilluan në përputhje me parimet dhe procedurat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i cili përbën bazën ligjore për garantimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe gjithëpërfshirëse. Kuadri ligjor synon të sigurojë një proces elektoral të administruar në mënyrë profesionale, me transparencë dhe me pjesëmarrje të barabartë të të gjitha palëve të interesuara.

Në nivel kombëtar, procesi zgjedhor u drejtua dhe u mbikëqyr nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që ka rol qendror në miratimin e akteve nënligjore, organizimin e fushatës informuese, trajnimin e komisionerëve dhe kontrollin e financimit të fushatave. KQZ, përmes Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), trajtoi ankesat dhe pretendimet për shkelje të ligjit zgjedhor, duke vepruar si një mekanizëm kontrolli dhe drejtësie administrative për subjekte dhe kandidatë.

Në nivel lokal, organizimi praktik i zgjedhjeve u realizua nga Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ), të ngritura në Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Këto struktura kishin në përgjegjësi organizimin e procesit logjistik, emërimin dhe trajnimin e komisionerëve të qendrave të votimit, shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe administrimin e qendrave të numërimit.

Në përgjithësi, funksionimi i KZAZ-ve u zhvillua në përputhje me afatet ligjore, por u dokumentuan disa problematika të natyrës organizative. Në disa raste u evidentuan vonesa në

trajnimin e komisionerëve dhe mungesë transparence në përzgjedhjen e disa anëtarëve të komisioneve, ku u vu re ndikimi i aktorëve politikë lokalë. Kjo ndikoi negativisht në përgatitjen profesionale të disa anëtarëve të komisioneve dhe në konsistencën e administrimit zgjedhor në ditën e votimit.

Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), të përbëra nga përfaqësues të partive politike, kishin detyrën për të garantuar zhvillimin korrekt të votimit, përfshirë identifikimin e votuesve përmes pajisjeve elektronike (PEI), ruajtjen e fshehtësisë së votës dhe raportimin e të dhënave të votimit. Monitorimi ynë evidentoi se në disa raste, sidomos në zonat rurale, komisionerët nuk kishin njohuri të plota për procedurat e administrimit të votës preferenciale, duke krijuar pasiguri në interpretimin e rregullave.

Numërimi i votave u zhvillua në ambiente të caktuara pranë KZAZ-ve, në prani të vëzhguesve vendorë, përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe përfaqësuesve të mediave. Procesi u shoqërua në disa raste me debate mbi vlefshmërinë e votave preferenciale dhe interpretimin e formulës së shpërndarjes së mandateve, çka solli vonesa në përfundimin e numërimit në disa zona.

Vëzhgimi qytetar, i realizuar nga organizata jonë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, luajti një rol të rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së procesit. Ai kontribuoi në evidentimin e problematikave, por edhe në promovimin e praktikave pozitive, si përmirësimi i infrastrukturës së qendrave të votimit dhe bashkëpunimi institucional në shumë zona. Sidoqoftë, monitorimi tregoi qartë se mbetet nevojë urgjente rritja e kapaciteteve të komisionerëve lokalë dhe zbatimi më i rreptë i kriterëve ligjore për përzgjedhjen e tyre.

3.3 Roli i partive politike dhe aktorëve lokalë

Subjektet politike që morën pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Qarkun Lezhë treguan një angazhim të ndryshëm në terren, në varësi të kapaciteteve organizative, strukturave lokale dhe strategjive të komunikimit. Fushata zgjedhore u karakterizua nga prani e theksuar e partive të mëdha dhe përpjekje të dukshme nga forcat politike të reja për të ndërtuar një raport më të afërt me komunitetin.

Partia Socialiste, si forcë në pushtet qendror dhe lokal, ndërtoi një fushatë të mirëorganizuar nga pikëpamja logjistike. Aktivitetet u zhvilluan në të tri bashkitë dhe përfshinë takime të shpeshta me qytetarët, prezantime në ambientet publike dhe përdorim të gjerë të mediave lokale. Megjithatë, përmbajtja e fushatës u fokusua kryesisht në arritjet qeveritare dhe investimet e kryera, pa u ndalur

në mënyrë të thelluar në problematikat e zonës apo në propozime konkrete për përmirësim. U evidentuan raste të përfshirjes së drejtuesve të institucioneve publike në aktivitete elektorale, çka ngre shqetësime për respektimin e ndarjes së funksioneve dhe barazinë në garë.

Koalicioni PD–ASHM zhvilloi një fushatë me ton të fortë opozitar, duke artikuluar mesazhe për ndryshim dhe kritika ndaj qeverisjes aktuale. Në shumë raste, fushata u përqendrua në qytetet kryesore dhe u mbështet nga figura publike me ndikim kombëtar, por pa një program të detajuar për zhvillimin e Qarkut Lezhë. Kjo ndikoi në mungesën e një komunikimi të strukturuar me komunitetin lokal për nevojat dhe prioritetet e tij.

Forcat e reja politike si “Nisma Shqipëria Bëhet” dhe “Lëvizja Bashkë” u angazhuan në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetarët përmes dëgjësive publike, forumeve me të rinjtë dhe aktiviteteve në terren. Ato sollën qasje të reja në mënyrën e zhvillimit të fushatës, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të përqendruar te çështjet lokale si korrupsioni, përfaqësimi gjinor, ndotja mjedisore dhe transparenca buxhetore.

Partia Socialdemokrate dhe subjektet më të vogla politike u angazhuan në një masë më të kufizuar, me pak aktivitete publike dhe më shumë përqendrim në zyrat elektorale. Kjo solli një prani më të dobët në fushatë dhe një ndikim të ulët në agjendën publike.

Aktorët lokalë – përfshirë drejtues të institucioneve publike, figura të komunitetit, të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile luajtën një rol të rëndësishëm në dinamizmin e fushatës. Organizatat vendore kontribuan në informimin e qytetarëve, edukimin zgjedhor dhe monitorimin e fushatës, duke nxitur rritjen e pjesëmarrjes dhe ndërtimin e një diskursi më përfaqësues dhe gjithëpërfshires.

4. PERIUDHA PARA ZGJEDHJEVE DHE FUSHATA ELEKTORALE

4.1 Aktivitetet e fushatës

Gjatë periudhës së fushatës elektorale për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025 në Qarkun Lezhë, subjektet politike kanë zhvilluar një aktivitet të dendur dhe të larmishëm për të komunikuar me zgjedhësit dhe për të promovuar kandidatët e tyre. Fushata është shtrirë në qytete dhe zona rurale, duke përfshirë një gamë të gjerë aktiviteteve tradicionale dhe moderne të komunikimit elektorale. Në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor që parashikon transparencë, barazi dhe respekt të rregullave gjatë fushatës, subjektet organizuan mitingje, takime komunitare dhe dëgjesa publike në sheshet kryesore të qyteteve, në mjedise të përshtatshme të komunitetit dhe në disa raste edhe në ambiente të bizneseve lokale që i vunë hapësirat e tyre në dispozicion.

Një nga format më të përhapura të komunikimit elektorale ishte metoda "derë më derë", e cila u përdor nga shumica e subjekteve për të kontaktuar drejtpërdrejt me qytetarët. Kjo metodë shërbeu për të ndërtuar një marrëdhënie më personale mes kandidatëve dhe zgjedhësve, duke mundësuar një shkëmbim më të drejtpërdrejtë të informacionit dhe opinioneve. Megjithatë, kjo praktikë është realizuar me intensitet të ndryshëm sipas strukturës dhe burimeve të disponueshme nga çdo subjekt politik.

Në territorin e Qarkut Lezhë u konstatuan zyra elektorale të ngritura dhe funksionale nga disa prej subjekteve kryesore si Partia Socialiste, Koalicioni PD–ASHM, Partia Socialdemokrate dhe Koalicioni Euroatlantik. Këto zyra, të shënuara qartë me logot dhe portretet e kandidatëve, u përdorën si qendra operationale për koordinimin e fushatës, shpërndarjen e materialeve promovuese dhe organizimin e takimeve me simpatizantët.

Në lidhje me materialet e marketingut politik, vëzhguesit konstatuan se nuk u respektuan në mënyrë të plotë dispozitat ligjore për vendosjen e tyre në hapësira të përcaktuara nga autoritetet vendore. Në vend të kësaj, posterat dhe fletëpalosjet u vendosën në mënyrë të pakontrolluar në ambiente private, si vitrinat e dyqaneve, fasadat e banesave dhe muret e ndërtesave përgjatë rrugëve kryesore. Kjo praktikë, ndonëse e përhapur, ka cenuar parimin e barazisë dhe ka vështirësuar kontrollin institucional mbi menaxhimin e hapësirave për fushatë.

Një tjetër trend i evidentuar ishte vendosja e posterave dhe materialeve propagandistike në automjete private apo të subjekteve politike. Kjo formë promovimi u përdor për të rritur

dukshmërinë e kandidatëve dhe për të mbuluar më shumë territor përmes lëvizjes së automjeteve në zonat urbane dhe rurale.

Përtej fushatës fizike, një pjesë e konsiderueshme e komunikimit elektoral u zhvillua në rrjetet sociale. Subjektet politike përdorën në mënyrë intensive Facebook, Instagram dhe platformat e tjera për të shpërndarë mesazhe, për të publikuar video promovuese dhe për të angazhuar ndjekësit përmes komenteve dhe ftesave për pjesëmarrje. Ky kanal komunikimi u bë gjithnjë e më vendimtar për arritjen e një audience më të gjerë, sidomos mes të rinjve dhe qytetarëve që ndjekin më shumë përmbajtjet online sesa aktivitetet në terren.

Sipas vëzhguesve afatgjatë të organizatës Sebastia, u evidentua një përfshirje e dukshme e administratës publike në promovimin e fushatës së Partisë Socialiste në rrjetet sociale, përmes pëlqimeve, shpërndarjeve dhe komenteve në postimet e kandidatëve. Ky fenomen ngre shqetësime mbi ndarjen e qartë mes funksioneve institucionale dhe angazhimit politik, veçanërisht kur përfshin punonjës të sektorit publik gjatë orarit të punës.

4.2 Përdorimi i burimeve publike

Gjatë monitorimit të periudhës së fushatës elektorale, vëzhguesit afatgjatë të Sebastias dokumentuan raste të përdorimit të burimeve publike nga përfaqësues të partive politike në pushtet. Në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, të drejtuara nga Partia Socialiste, kandidatët e kësaj force politike u shoqëruan gjatë aktiviteteve elektorale nga kryetarët e bashkive, si dhe nga drejtues të institucioneve lokale si drejtorë shkollash, mësues, punonjës të zjarrfikëses dhe përfaqësues të zyrave të kadastrës. Kjo prani institucionale në fushatë përbën një shembull të qartë të përzierjes së funksioneve publike me ato politike, duke minuar parimin e barazisë në garë.

Në rastin e Bashkisë Mirditë, e cila drejtohet nga Partia Demokratike, u dokumentua përfshirja e kryetarit të bashkisë në aktivitetet elektorale të kandidatëve të subjektit të tij politik. Edhe pse në një kontekst tjetër politik, kjo tregon se përdorimi i burimeve institucionale për qëllime elektorale është një fenomen i përhapur përtej vijave partiake.

Megjithëse shumica e aktiviteteve janë zhvilluar pas orarit zyrtar të punës, fakti që funksionarë publikë janë përfshirë në mënyrë aktive në fushatë ngre dyshime për presion të mundshëm mbi nëpunësit civilë dhe për përdorimin simbolik të autoritetit institucional për të favorizuar një subjekt politik. Kjo është në kundërshtim me nenet e Kodit Zgjedhor dhe me parimet e administratës publike të paanshme dhe të depolitizuar.

Nga monitorimi nuk rezultoi përdorimi i mjeteve zyrtare të transportit apo i ambienteve të institucioneve publike për qëllime elektorale, çka është një tregues pozitiv për respektimin formal të disa rregullave të fushatës. Po ashtu, nuk u evidentuan aktivitete të zhvilluara në ambiente publike pa leje të posaçme, çka sugjeron një nivel të caktuar disipline institucionale në këtë aspekt.

4.3 Presione dhe intimidime

Megjithëse nuk u raportuan raste konkrete të dhunës fizike apo intimidimit të drejtpërdrejtë gjatë fushatës zgjedhore në Qarkun Lezhë, klima psikologjike në disa zona është karakterizuar nga frikë, hezitim dhe ndjenjë pasigurie. Kjo u reflektua në deklaratat e shumë qytetarëve që shprehën shqetësimin se pjesëmarrja në takimet e fushatës mund të identifikohet përmes fotografive apo regjistrimeve dhe se kjo mund të ketë pasoja për vendin e punës apo për marrëdhëniet institucionale që ata ose familjarët e tyre kanë me shtetin.

Në veçanti, punonjës të administratës publike dhe familjarë të tyre ndihen të ekspozuar ndaj presionit të heshtur për të mbështetur subjektin në pushtet, përndryshe mund të rrezikojnë pozitën e tyre ose të përballen me forma të ndryshme marginalizimi në vendin e punës. Kjo formë e presionit të tërthortë ndikon në klimën e përgjithshme të fushatës dhe në lirinë e zgjedhjes së qytetarëve.

Një tjetër formë intimidimi është prezenca dhe përfshirja e individëve me precedentë penalë ose me reputacion të diskutueshëm që mbështesin publikisht kandidatët e caktuar. Ky fenomen, i njohur në zhargonin lokal si "prania e të fortëve", ndikon negativisht në atmosferën e fushatës dhe shkakton ndjesi pasigurie tek qytetarët, sidomos në zonat rurale ku lidhjet personale dhe ndikimi i aktorëve informalë është më i madh.

4.4 Shkeljet dhe parregullsitë e evidentuara

Gjatë fushatës zgjedhore janë konstatuar disa shkelje dhe parregullsi që bien ndesh me ligjin zgjedhor dhe ndikojnë në barazinë e garës dhe transparencën e procesit:

- ♦ **Mosvendosja e posterave në vendet e përcaktuara ligjërisht:** Në shumë raste, subjektet politike nuk i kanë vendosur materialet propagandistike në hapësirat e përcaktuara nga bashkitë. Kjo shkelje cenon barazinë në promovimin vizual dhe dëmton hapësirat publike.
- ♦ **Mungesa e shënjitimit të qartë të burimit të materialeve:** Shumë prej materialeve propagandistike, përfshirë fletëpalosje dhe postera, nuk përmbanin të dhëna mbi

financimin, siç kërkohet nga neni 114 i Kodit Zgjedhor. Kjo mungesë transparence ngre dyshime mbi burimin dhe ligjshmërinë e fondeve të përdorura.

- ♦ **Shkelja e periudhës së heshtjes zgjedhore:** Janë regjistruar postime në rrjetet sociale nga subjekte politike edhe pas fillimit të periudhës së heshtjes. Këto veprime bien ndesh me rregullat që synojnë sigurimin e një ambienti të qetë dhe të paanshëm për reflektim nga votuesit.
- ♦ **Mungesa e transparencës financiare:** Nuk u evidentuan raportime të plota publike nga subjektet politike për shpenzimet e tyre gjatë fushatës. Kjo mospërputhje me kërkesat ligjore për raportim financiar pengon kontrollin dhe vlerësimin e drejtë të fondeve të përdorura.

5. DITA E VOTIMIT – 11 MAJ 2025

5.1 Hapja e qendrave të votimit

Hapja e qendrave të votimit në Qarkun Lezhë nisi kryesisht në orën 07:00, ashtu siç ishte parashikuar në udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Megjithatë, në disa nga qendrat e votimit që u monitoruan nga Shoqata Sebastia, u shënua një vonesë prej disa minutash në fillimin e procesit të votimit. Kjo vonesë ishte kryesisht për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI), të cilat janë të domosdoshme për verifikimin e identitetit të votuesve. Për shkak të këtij problemi teknik, u desh ndërhyrja e stafit teknik për të rregulluar dhe aktivizuar pajisjet. Pas ndërhyrjes së tyre, procesi i votimit filloi normalisht dhe pa probleme të mëtejshme. Kjo situatë shkaktoi vonesa të vogla, por që nuk ndikuan në mënyrë të rëndësishme në vijimësinë e procesit zgjedhor. Në përgjithësi, hapja e qendrave të votimit u realizua brenda afateve të kërkuara dhe në përputhje me ligjin.

Në qendrat e votimit të monitoruara nga Shoqata Sebastia në Qarkun Lezhë, komisionet zgjedhore ishin ngritur sipas përkatësisë politike, në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, gjatë hapjes së procesit të votimit u evidentuan mangësi në kontrollin e fletëve të votimit në disa qendra votimi. Në këto raste, fletët e votimit nuk u verifikuan në mënyrë të duhur para fillimit të procesit, për shkak të mungesës së njohurive dhe përgatitjes së pamjaftueshme të anëtarëve të komisioneve për detyrat specifike që u ishin ngarkuar. Kjo situatë krijoi rrezik për shkelje dhe parregullsi gjatë votimit, duke nxjerrë në pah nevojën për trajnim më të mirë dhe informim më të detajuar të anëtarëve të komisioneve zgjedhore për të garantuar respektimin e procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

5.2 Procesi i identifikimit dhe regjistrimit të votuesve

Gjatë procesit të identifikimit dhe regjistrimit të votuesve në qendrat e votimit të monitoruara nga Shoqata Sebastia në Qarkun Lezhë u vunë re disa problematika të rëndësishme. Shumë votues gjatë procesit nuk kishin informacion të mjaftueshëm për vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit, çka shkaktoi vështirësi dhe vonesa në qasjen në vendvotim. Gjithashtu, gjatë procesit të votimit, një pjesë e votuesve nuk kishin informacion të qartë se si duhet të përdornin fletën e votimit, gjë që krijoi konfuzion dhe ngatërresa.

Në aspektin teknik, pajisja elektronike e identifikimit (PEI) gjatë procesit paraqiti probleme të përsëritura, veçanërisht me njohjen e shenjës së gishtit, duke ngadalësuar rrjedhën e votimit dhe rritur kohën e pritjes në disa qendra votimi. Për më tepër, operatorët e PEI-së në disa prej këtyre qendrave nuk kishin marrë trajnim adekuat, gjë që ndikoi në zgjidhjen e vonuar të problemeve teknike dhe menaxhimin jo optimal të pajisjeve gjatë procesit.

5.3 Votimi dhe respektimi i fshehtësisë

Një prej problemeve më të shpeshta ishte praktika e votimit familjar. Në disa raste, anëtarë të familjes ushtronin të drejtën e votës në emër të personave me aftësi të kufizuara ose të moshuar, pa respektuar procedurat e detajuara dhe pa regjistruar procesverbal sipas Kodit Zgjedhor. Kjo praktikë krijon dyshime mbi vullnetin e lirë të votuesve dhe cenon fshehtësinë dhe pavarësinë e votës, duke shkelur kështu të drejtën themelore të votimit individual.

Gjithashtu, në disa qendra votimi u vërejt komunikim publik dhe me zë të lartë gjatë procesit të votimit. Komisionerët ose personat e pranishëm përmendnin hapur emrat e kandidatëve apo numrat e subjekteve politike, duke ekspozuar votuesit ndaj presioneve dhe ndikimeve të mundshme. Kjo situatë krijon ambient të papërshtatshëm për votuesit, të cilët duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre në mënyrë të fshehtë dhe pa presion.

5.4 Mbyllja e qendrave të votimit

Mbyllja u realizua në oraret e paracaktuara nga Kodi Zgjedhor. Komisionet e votimit filluan procedurat e mbylljes menjëherë pas orarit zyrtar të përfundimit të votimit, duke respektuar afatet ligjore. Transportimi i kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore është kryer në bazë të rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

5.5 Shkeljet dhe parregullsitë gjatë ditës së votimit

Gjatë ditës së votimit më 11 maj 2025, vëzhguesit e Shoqatës Sebastia evidentuan një sërë parregullsish që çenojnë standardet e integritetit, barazisë dhe fshehtësisë së procesit zgjedhor. Këto problematika u regjistruan në të gjitha fazat e ditës së votimit, nga hapja deri në mbylljen e qendrave të votimit.

- ◆ Vonesa në hapjen e disa qendrave të votimit, për shkak të problemeve teknike me pajisjet PEI, që kërkuar ndërhyrje të teknikëve.

- ◆ Mungesë kontrolli të fletëve të votimit nga komisionerët në fillim të ditës, si pasojë e mosnjohjes së procedurave të detajuara ligjore.
- ◆ Probleme me funksionimin e pajisjeve PEI, kryesisht me njohjen e shenjave të gishtave, që shkaktuan vonesa dhe konfuzion.
- ◆ Operatorë të patrajnuar mirë të PEI-së, të cilët e kishin të vështirë të menaxhonin situata teknike dhe të udhëzonin votuesit.
- ◆ Votues të painformuar për vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit, gjë që solli vonesa dhe pengesa në ushtrimin e të drejtës së votës.
- ◆ Mungesë informacioni mbi mënyrën e votimit, çka u reflektua në konfuzion dhe pasiguri në kabinat e votimit.
- ◆ Mungesë e infrastrukturës për persona me aftësi të kufizuara, duke i pamundësuar ose vështirësuar aksesin në qendra të votimit për këtë kategori.
- ◆ Raste të votimit familjar, ku persona votuan në emër të familjarëve të moshuar apo me aftësi të kufizuara, pa ndjekur procedurat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe pa hartuar procesverbal.
- ◆ Komunikim me zë të lartë i preferencave politike, ku në disa qendra votimi u dëgjuan emra kandidatësh apo numra partish të artikuluar hapur, në kundërshtim me parimin e fshehtësisë së votës.
- ◆ Prania e personave të tjerë në kabinën e votimit, ose ndërhyrje të drejtpërdrejta gjatë votimit, që ndikojnë në fshehtësinë e votës.
- ◆ Prani e automjeteve me materiale propagandistike (postera dhe portrete kandidatësh) pranë qendrave të votimit, në kundërshtim me heshtjen zgjedhore dhe Kodin Zgjedhor.
- ◆ Prani fizike e kandidatëve apo përfaqësuesve të subjekteve politike në ambientet ose afërsi të qendrave të votimit, e cila mund të ndikojë psikologjikisht tek votuesit dhe krijon një klimë presioni.

6. PROCESI I NUMËRIMIT

6.1 Organizimi dhe mbarëvajtja e numërimit

Gjatë procesit të numërimit të votave, aktiviteti u zhvillua në ambientet e përshtatshme dhe të sigurta brenda Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ), të cilat ishin të përgatitura për t'i mundësuar anëtarëve të numërimit punën në kushte të përshtatshme dhe të kontrolluara. Ambientet ishin të organizuara në mënyrë që të sigurohej qartësia dhe rregullsia gjatë gjithë procesit.

Anëtarët e numërimit të votave ishin të përgatitur për të kryer procedurat sipas udhëzimeve të Kodit Zgjedhor dhe rregullave të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Numërimi u realizua fillimisht për votat e subjekteve politike, duke u përqendruar në numërimin e saktë të votave të vlefshme dhe të pavlefshme, dhe më pas u vijua me numërimin e votave preferenciale për kandidatët. Gjatë këtij procesi u respektua rendi dhe procedurat ligjore për të garantuar një proces transparent dhe të drejtë.

Pranë numërimit ishin të pranishëm vëzhgues nga subjektet politike të ndryshme, si dhe vëzhgues të pavarur, të cilët monitoruan me kujdes çdo fazë të procesit. Prania e këtyre vëzhguesve kontribuoi në rritjen e besueshmërisë së procesit të numërimit dhe ndihmoi në identifikimin e çdo problematike apo parregullsie që mund të kishte.

Gjithashtu, numërimi u zhvillua brenda afateve kohore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, pa shenja të vonesave të konsiderueshme apo ndërprerjeve. Komisionerët e numërimit punuan me përkushtim për të përfunduar këtë fazë të rëndësishme në kohë dhe në mënyrë korrekte, duke respektuar plotësisht procedurat ligjore dhe rregullat e përcaktuara për këtë proces.

6.2 Dokumentimi dhe transparencja

Procesi i dokumentimit dhe transparencës gjatë numërimit të votave në KZAZ-të e monitoruara nga Shoqata Sebastia (KZAZ nr. 12, 13 në Lezhë, nr. 14 në Mirditë dhe nr. 15 në Kurbin) është vlerësuar përgjithësisht si i rregullt dhe i ndjekur sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Në të gjitha qendrat e numërimit ku ishin të pranishëm vëzhguesit tanë, u konstatua se procesi i dokumentimit është zhvilluar në mënyrë të strukturuar. Materialet zgjedhore, përfshirë kutitë e votimit, fletët e votimit dhe procesverbalet, u administruan dhe dokumentuan sipas procedurave

përkatëse. Për çdo hap të numërimit u plotësuan formularët përkatës dhe u mbajtën shënime të detajuara nga anëtarët e grupeve të numërimit.

Gjithashtu, përveç vëzhguesve të Shoqatës Sebastia, në ambientet e numërimit kanë qenë të pranishëm edhe vëzhgues të subjekteve zgjedhore dhe vëzhgues të pavarur, të cilët patën mundësinë të ndjekin nga afër çdo hap të procesit. Kjo ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe në ndërtimin e besimit të publikut ndaj rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Megjithatë, në disa raste të izoluara u vunë re vonesa në komunikimin e të dhënave ndërmjet grupeve të numërimit dhe KZAZ-ve, si dhe paqartësi momentale në plotësimin e disa formularëve, për shkak të mungesës së përvojës së disa anëtarëve të grupeve të numërimit. Këto çështje nuk ndikuan në integritetin e përgjithshëm të procesit, por tregojnë nevojën për përmirësim të trajnimit dhe të rritjes së kapaciteteve teknike të personelit të përfshirë në numërim.

6.3 Problematikat dhe shkeljet e evidentuara

Gjatë monitorimit të procesit të numërimit të votave në Qendrat e Numërimit në qarqet Lezhë dhe Shkodër, janë evidentuar një sërë problematikash që kanë ndikuar në transparencën, qetësinë dhe standardet e administrimit të këtij procesi. Më poshtë paraqiten rastet më të shpeshta dhe të përsëritura:

- ◆ Tentativa për të ndikuar në interpretimin e fletëve të pavlefshme
Në disa raste u vërejtën përpjekje nga përfaqësues të subjekteve politike për të ndikuar në vendimmarrjen e komisionerëve në lidhje me vlefshmërinë e disa fletëve të votimit, sidomos në rastet ku shenjat ishin të paqarta. Këto ndërhyrje krijuan tension dhe vonesa në proces.
- ◆ Debate politike dhe përplasje verbale mes aktorëve të pranishëm
Procesi i numërimit u ndërpre në disa raste për shkak të debateve të ashpra ndërmjet përfaqësuesve të partive politike, të cilat krijuan një atmosferë të tensionuar dhe ndikuan negativisht në mbarëvajtjen normale të punës së komisioneve të numërimit.
- ◆ Prani e personave të paautorizuar në ambientet e numërimit
Në disa qendra u konstatua prania e një numri të lartë personash të paautorizuar brenda ambjentit të numërimit, gjë që jo vetëm binte ndesh me rregullat për sigurinë dhe

administrimin e procesit, por ndikonte edhe në krijimin e konfuzionit dhe rrjedhimisht në ecurinë e punës.

- ◆ Komunikim i papërshtatshëm dhe me zë të lartë gjatë procesit Përdorimi i zërit të lartë dhe komunikimi joetik nga disa anëtarë të komisioneve dhe përfaqësues politikë u evidentua si një sjellje e përsëritur që dëmtonte klimën e qetë të punës dhe përqendrimin e numëruesve.
- ◆ Shfaqje e pamjaftueshme e fletëve të votimit në monitor Në disa raste, fletët e votimit u shfaqën në ekran për më pak se tre sekonda, kohë e pamjaftueshme për të mundësuar një verifikim të qartë nga vëzhguesit dhe përfaqësuesit e subjekteve. Kjo praktikë cenon transparencën dhe krijon dyshime mbi saktësinë e procesit të numërimit.
- ◆ Vëzhguesit e subjekteve politike bllokojnë pamjen e monitorëve Vëzhguesit e disa partive politike nuk respektojnë rregullat e vendosura për qëndrimin e tyre në ambient. Ata qëndronin në këmbë përpara pajisjeve të monitorimit, duke bllokuar pamjen për aktorë të tjerë të pranishëm dhe duke kufizuar ndjeshëm mundësinë për ndjekje të qartë të procesit nga vëzhguesit e pavarur.

6.4 Raportimi dhe shpallja e rezultateve

Procesi i raportimit dhe shpalljes së rezultateve në qarqet Lezhë dhe Shkodër u ndoq në vijimësi nga ekipi i monitorimit. Edhe pse në pjesën më të madhe të rasteve ky proces u zhvillua në përputhje me afatet ligjore, u evidentuan disa problematika që ndikuan në perceptimin e transparencës dhe besueshmërisë së rezultateve:

- ◆ Vonesa në përditësimin dhe afishimin e rezultateve paraprake Në disa raste u vunë re vonesa të konsiderueshme në raportimin e rezultateve paraprake nga KZAZ-të, duke ndikuar negativisht në informimin e publikut dhe të aktorëve zgjedhorë mbi ecurinë e procesit të numërimit.
- ◆ Mospërputhje mes procesverbaleve dhe tabelave përmbledhëse Janë konstatuar raste ku të dhënat e deklaruara në tabelat përmbledhëse nuk përputheshin plotësisht me ato të pasqyruara në procesverbalet e qendrave të votimit. Këto

mospërputhje, kryesisht teknike ose aritmetike, sollën pasaktësi në raportimin fillestar të rezultateve.

7. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME

7.1 Përfundime të përgjithshme

Zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 11 maj 2025 në Qarkun Lezhë përfaqësojnë një moment të rëndësishëm të zhvillimit demokratik në nivel lokal dhe kombëtar. Monitorimi i kryer nga Shoqata Sebastia në këtë qark ka mundësuar evidentimin e një tabloje të qartë mbi funksionimin real të procesit zgjedhor, përfshirë fazën e përgatitjes, ditën e votimit dhe numërimin e votave. Pavarësisht nga përpjekjet institucionale për të përmbushur standardet ligjore dhe ndërkombëtare, procesi ka patur një sërë mangësish që reflektojnë nevojën për reforma të vazhdueshme dhe thelbësore.

Në aspektin teknik dhe organizativ, është evidentuar se ndërsa përgatitja infrastrukturore dhe shpërndarja e materialeve zgjedhore ishte përgjithësisht e mirë menaxhuar, përgatitja njerëzore konkretisht në trajnimet për komisionerët dhe operatorët teknikë rezultoi e pamjaftueshme. Vonesat në hapjen e qendrave të votimit, mungesa e kontrollit të fletëve të votimit, dhe vështirësitë në përdorimin e pajisjeve të identifikimit elektronik PEI, ndikuan negativisht në ecurinë dhe efikasitetin e procesit.

Një aspekt kritik i vërejtur lidhet me të drejtat e votuesve dhe respektimin e tyre në praktikë. Votimi familjar, mungesa e fshehtësisë, mosrespektimi i heshtjes zgjedhore dhe prania e materialeve propagandistike në afërsi të qendrave të votimit, dëshmojnë për mungesën e një kulture të konsoliduar zgjedhore si dhe për mungesën e zbatimit rigoroz të ligjit nga strukturat përgjegjëse. Për më tepër, personat me aftësi të kufizuara vijojnë të përjashtohen faktikisht nga e drejta e votës për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme.

Nga ana tjetër, vlen të përmendet se numërimi i votave u zhvillua në ambiente të përshtatshme dhe në prani të vëzhguesve, duke mundësuar një nivel relativ të transparencës. Megjithatë, edhe ky proces nuk ishte i imunizuar nga problematikat.

Prania e personave të paautorizuar në qendrat e numërimit, tensionet dhe debatet politike, si dhe paqartësitë në plotësimin e dokumentacionit kanë rritur dyshimet mbi integritetin e pjesëve të caktuara të procesit.

Raportimi i rezultateve dhe komunikimi me publikun u karakterizua nga vonesa dhe mospërputhje të të dhënave ndërmjet procesverbaleve dhe tabelave përmbledhëse. Këto dobësi jo vetëm që cenojnë transparencën, por kontribuojnë edhe në uljen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve zgjedhore.

Në tërësi, mund të thuhet se procesi zgjedhor nuk u karakterizua nga shkelje massive apo të qëllimshme që do të delegjitimonin rezultatin final, por u shoqërua me një sërë dobësish sistemike që duhen adresuar me urgjencë. Këto dobësi nuk janë të rastësishme, por pasqyrim i mungesës së koordinimit institucional, investimit të pamjaftueshëm në edukimin zgjedhor, dhe zbatimit selektiv të rregullave ligjore.

Shoqata Sebastia vlerëson se për të arritur zgjedhje vërtetë demokratike, procesi zgjedhor duhet të shoqërohet me angazhim të përhershëm të institucioneve, vullnet politik, pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe një qytetari të informuar. Monitorimi i vitit 2025 ofron një pasqyrë të vlefshme mbi sfidat aktuale, duke shërbyer si bazë për përmirësimet e nevojshme në të ardhmen.

7.2 Rekomandime strategjike për proceset e ardhshme

Bazuar në gjetjet e monitorimit në Qarkun Lezhë, Shoqata Sebastia paraqet rekomandimet e mëposhtme për të rritur cilësinë, transparencën dhe integritetin e proceseve zgjedhore në të ardhmen:

Forcimi i kapaciteteve të administratës zgjedhore:

- ◆ Të rritet cilësia dhe kohëzgjatja e trajnimeve për anëtarët e komisioneve, duke përfshirë module praktike dhe vlerësim përpara emërimit.

- ◆ Të përfshihen ekspertë të jashtëm dhe OJF për të ofruar trajnime të pavarura mbi etikën, standardet ndërkombëtare dhe menaxhimin e situatave konfliktuale.
- ◆ Zbatimi i certifikimit të detyrueshëm për operatorët e PEI:
- ◆ Të krijohet një skemë kombëtare certifikimi dhe testimi për të gjithë operatorët e teknologjisë zgjedhore përpara përfshirjes së tyre në proces.
- ◆ KQZ të ofrojë manuale të përditësuara dhe simulime digjitale për përdorim gjatë trajnimeve.

Përmirësimi i aksesit për persona me aftësi të kufizuara:

- ◆ Të miratohen udhëzime detyruese për çdo qendër votimi për të siguruar rampa, ndriçim, sinjalistikë dhe ndihmës për votuesit me aftësi të kufizuara.
- ◆ Bashkëpunim i drejtpërdrejtë me shoqatat që përfaqësojnë këtë kategori për të zhvilluar standarde gjithëpërfshirëse.

Edukim dhe ndërgjegjësim qytetar:

- ◆ Fushata të rregullta informuese përmes TV, rrjeteve sociale dhe takimeve komunitare për të shpjeguar procedurat zgjedhore.
- ◆ Materiale të thjeshta vizuale në gjuhë të ndryshme, përfshirë gjuhën e shenjave, për të informuar rreth të drejtës së votës.

Mbikëqyrje më e fortë e heshtjes zgjedhore:

- ◆ Vendosja e mekanizmave të shpejtë raportimi dhe reagimi për shkeljet e heshtjes zgjedhore nga qytetarët dhe OJF-të.

- ◆ Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për subjektet që shpërndajnë materiale apo qëndrojnë pranë qendrave të votimit.
- ◆ Modernizimi i sistemit të raportimit dhe publikimit të rezultateve:
- ◆ Krijimi i një platforme të hapur për publikun për të ndjekur rezultatet në kohë reale, duke përfshirë grafikë dhe analizë statistikore.
- ◆ Standardizimi i të dhënave për të shmangur mospërputhjet ndërmjet procesverbaleve dhe tabelave përmbledhëse.

Zgjerimi dhe fuqizimi i rolit të vëzhguesve të pavarur:

- ◆ Rishikimi i procedurave për akreditimin e vëzhguesve për të lehtësuar përfshirjen e më shumë aktorëve të shoqërisë civile.
- ◆ Përdorimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit për të lejuar raportim në kohë reale nga terreni.

Unifikimi i dokumentacionit dhe procedurave zgjedhore:

- ◆ Hartimi i një manuali unik operacional për të gjitha fazat e procesit zgjedhor, i detyrueshëm për të gjitha KZAZ-të.
- ◆ Monitorim i vazhdueshëm për zbatimin e këtyre standardeve në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë vendin.

Përfshirje më e gjerë gjinore dhe rinore në procesin zgjedhor:

- ◆ Kuota të rekomanduara për përfaqësim të grave dhe të rinjve në komisione dhe në rolet drejtuese të administrimit zgjedhor.

- ◆ Programe mentorimi dhe trajnimet për të ndihmuar të rinjtë që të angazhohen në mënyrë aktive në proces.

Monitorim institucional dhe ndërinstitutional më gjithëpërfshirës:

- ◆ Forcimi i rolit të institucioneve si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizatat e shoqërisë civile në ndjekjen e shkeljeve zgjedhore.
- ◆ Krijimi i një grupi ndërinstitutional për monitorim para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, me raportime publike.

Këto rekomandime nuk synojnë vetëm korrigjimin e mangësive të identifikuara gjatë zgjedhjeve të majit 2025, por edhe ndërtimin e një arkitekture më të fortë dhe të qëndrueshme zgjedhore për të ardhmen. Shoqata Sebastia mbetet e angazhuar për të kontribuar në përmirësimin e demokracisë zgjedhore në vend përmes monitorimit të pavarur, advokimit dhe pjesëmarrjes qytetare.